



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS - MALISHEVË



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Nr. _____

Malishevë, me 27.02.2017

Projekti komunal për përkrahjen në zhvillimin e kulturave perimore (ngritja e serrave)

Në kuadër të Zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë –Perimkulturës, Komuna e Malisheves respektivisht Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural publikon :

SHPALLJE

Ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin e ngritjes së serrave në sipërfaqe prej 100 m². Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në këtë projekt do të kontribuoj me:

- Financimi me 70 % të kostos së serrës
- Këshillime profesionale dhe monitorim të vazhdueshëm të fermerëve përmes ekspertëve të kësaj drejtorie.

Kriteret e konkurrimit:

1. Fermeri duhet të jetë banor i komunës së Malisheves
2. Të ketë njohuri evidente në kultivimin e perimeve
3. Të posedoj sipërfaqe tokësore të mjaftueshme për vendosjen e serrës
4. Të ketë mundësi ujitje për serrë
5. Të jetë i gatshëm të Paguaj paraprakisht 30% të mjeteve financiare në koston e serrës
6. Përparësi kanë fermerët, toka e të cilëve është e përshtatshme për kultivimin e perimeve dhe të cilët nuk kanë përfituar asnjëherë nga projektet e komunës.
7. Nr. I serrave (eshte i kufizuar) ne 50 sishe.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

1. Kërkesa e shkruar nga vetë fermeri dhe numri kontaktues i telefonit
2. Fleta poseduese dhe kopja e planit
3. Vërtetimi i tatimit në pronë
4. Letërnjoftimi kopje

Afati i aplikimit nga data 01.03.2017 deri me 25.03.2017

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në sportelin e pritjes paleve dhe regjistrohet në protokollin e Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural- Malisheve.

Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drejtori i Bujqësisë

Murat Hoxha Dr.Mr. Vet.